



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:066306

Datë: 30.05.2019

Numri i dokumentit: 00338709

P.nr.1803/18

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Shpresa Emra me pjesëmarrjen e sekretares juridike Birsen Shoshani, në çështjen penale kundër të akuzuarve Sh.K dhe L.K, nga fshati, komuna e, për shkak të veprës penale sulm nga neni 187 par. 3 lidhur me par. 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe kundër të akuzuarve L.K dhe B.K për shkak të veprës penale sulm nga neni 187 par.3 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KP-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, PP/II.nr.2380-1/18 të dt.08.11.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar gjyqësor në prezencën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, Prokurorit të Shtetit Atnor Skoro dhe të akuzuarve me date 15.05.2019, publikisht mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1.L. K., nga i ati B. dhe e ëma I., e lindur B., i lindur më, në fshatin-komuna e, ku edhe jeton, ka të kryer shkollën fillore, punëtor, i gjendjes së dobët ekonomike, beqar, shqiptar, shtetasi Republikë së Kosovës, me letërnjoftim nr.....;

2.Sh. K, nga i ati B. dhe e ëma I., e lindur B, I lindur më, në fshatin-komuna e, ku edhe jeton, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, babe i fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, mekanik, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër të letërnjoftimit

3.L.K, nga i ati B. dhe e ëma I., e lindur B., i lindur më, në fshatin-komuna e, ku edhe jeton, ka të kryer shkollën e mesme, mekanik, i martuar, babë i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me letërnjoftim nr..... ,

4. B.K., nga i ati A dhe e ëma B., e lindur M., i lindur më, në fshatin-komuna e, ku edhe jeton ka të kryer shkollën fillore, I gjendjes ekonomike mesatare, tornitor, i martuar, babë i fëmijëve, shqipëtar , shtetas I Republikës së Kosovës, me letrënjoftim nr.....

JANË FAJTOR

I. Të pandehurit Sh.Kdhe L.K

Se me date 11.09.2018, rreth ores 15:00, në fshatin, Komuna e, saktësisht në oborrin e përbashkët të shtëpisë së tyre, me dashje në bashkëveprim përdorin forcën ndaj të dëmtuarve (pandehurve)- L. K dhe B. K, që në marrëdhënie familjare janë babai dhe fëmijët, në atë mënyrë që të pandehurit pas një mosmarrëveshje paraprake në mes vete lidhur me çështjen që çelësave të veturës ka ardhur deri te acarimi në mes tyre gjë që të pandehurit i sulmojnë fizikisht të dëmtuarit (të pandehurit) vëllain L.K dhe të babain B.K fizikisht me grushte, me të cilat veprime të dëmtuarit nuk kanë pësuar lëndime trupore, pasi që nuk kanë pranuar ndihmë mjekësore.

Me këto veprime kanë kryer veprën penale sulmi nga neni 187 par 3 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, nr. 04/L-082.

II. Të pandehurit L.K dhe B. K.

Se me date, kohë dhe vend të njëjtë të përshkruar si në pikën I. të dispozitivit të kësaj aktakuze me dashje në bashkëveprim përdorin forcën ndaj të dëmtuarve (të pandehurve) Sh.K dhe L.K në atë mënyrë të përshkruar si në dispozitivin I të aktakuzës, rreth çelësave të një veture, ka ardhur deri te acarimi i tyre në mes vete gjë që të pandehurit i kundërvihen me sulm fizik të dëmtuarve (të pandehurve) duke i sulmuar fizikisht me grushte me të cilat veprime të dëmtuarit (të pandehurit) nuk kanë pësuar lëndime trupore pasi që të njëjtit nuk kanë pranuar ndihmë mjekësore.

Me këto veprime kanë kryer veprën penale sulmi nga neni 187 par 3 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, nr. 04/L-082.

Andaj gjykata në kuptim të dispozitave të neneve: 7, 8, 9, 10, 41, 42, 49, 50, 51, 52, 73 dhe të neneve 187 par. 3 lidhur me par. 1 dhe nenin 31 të KP-së, të akuzuarit I gjykon dhe u shqipton:

DËNIMIN ME BURGIM KUSHT

Të akuzuarit L.K i shqiptohet dënimi me burgim me kusht duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje **prej 4 (katër) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin kohor prej 1 (një) viti** nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

Të akuzuarit Sh.K i shqiptohet dënimi me burgim me kusht duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje **prej 4 (katër) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin kohor prej 1 (një) viti** nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

Të akuzuarit L.K i shqiptohet dënimi me burgim me kusht duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje **prej 4 (katër) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin kohor prej 1 (një) viti** nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

Të akuzuarit B.K i shqiptohet dënimi me burgim me kusht duke i vërtetuar dënimin me burgim **në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin kohor **prej 1 (një) viti** nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

Obligohen të akuzuarit që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë secili shumën me nga 20 Euro, dhe për Fondin e Kompensimit të Viktimave shumën prej nga 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, ka parashtruar Aktakuzë PP/II.nr.2380-1/18 të dt. 08.11.2018, kundër të akuzuarve L.K dhe Sh.K nga fshati, Komuna e, për shkak se ka kryer veprën penale sulm nga neni 187 par.3 lidhur me par. 1 dhe nenin 31 të KPRK-së, si dhe ndaj të akuzuarve L.K dhe B.K nga fshati, Komuna e, për shkak se ka kryer veprën penale sulm nga neni 187 par.3 lidhur me par. 1 dhe nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata në këtë çështje penale duke vepruar sipas Aktakuzës ka caktuar shqyrtimin fillestar në të cilin të akuzuarit Sh. K, L. K, L.K dhe B.K kanë pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohen si në dispozitiv aktgjykimi.

Lidhur me pranimin e fajësisë të akuzuarve i prokurori i shtetit nuk e ka kundërshtuar pranimin e fajësisë nga të njëjtit.

Bazuar në aktin e pranimit të fajësisë dhe konform dispozitave të nenit 246 e 248 të KPP-së, gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këto gjendje faktike:

Se me date 11.09.2018, rreth orës 15:00, në fshatin, Komuna e, saktësisht në oborrin e përbashkët të shtëpisë së tyre, të akuzuarit Sh.K dhe L.K me dashje në bashkëveprim përdorin forcën ndaj të dëmtuarve(pandehurve)- L. K dhe B. K, që në marrëdhënie familjare janë babai dhe fëmijët, në atë mënyrë që të pandehurit pas një mosmarrëveshje paraprake në mes vete lidhur me çështjen që çelësave të veturës ka ardhur deri te acarimi në mes tyre gjë që të pandehurit i sulmojnë fizikisht të dëmtuarit (të pandehurit) të dëmtuarin- vëllain L.K dhe të dëmtuarin-babain B.K duke i sulmuar fizikisht me grushte, me të cilat veprime të dëmtuarit nuk kanë pësuar lëndime trupore, pasi që nuk kanë pranuar ndihmë mjekësorë.

Gjithashtu me datë, kohë dhe vend të njëjtë të përshkruar si në pikën I të dispozitivit të kësaj aktakuzë të akuzuarit L.K dhe B.K me dashje në bashkëveprim përdorin forcën ndaj të dëmtuarve (të pandehurve) Sh.K dhe L.K në atë mënyrë të përshkruar si në dispozitivin I të aktakuzës, rreth çelësave të një veture, ka ardhur deri te acarimi i tyre në mes vete gjë që të pandehurit i kundërvihen me sulm fizik të dëmtuarve (të pandehurve) duke i sulmuar fizikisht me grushte me të cilat veprime të dëmtuarit (të pandehurit) nuk kanë pësuar lëndime trupore pasi që të njëjtit nuk kanë pranuar ndihmë mjekësore.

Sipas detyrës zyrtare gjykata, konform nenit 257 të KPP-së, nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale e cila u vihet në barrë e që pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzime. Pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat të akuzuarit kanë qenë të njoftuar me kohë me të gjitha provat materiale.

Gjykata erdhi në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së dhe faktet që përmban aktakuza, ku në veprimet e të akuzuarve Sh.K dhe L.K formohen të gjitha elementet e veprës penale të sulmit nga neni 187 par 3 lidhur me par.1 e lidhur me neni 31 të KP-së si dhe në veprimet e të akuzuarve L.K dhe B.K formohen të gjitha elementet e veprës penale të sulmit nga neni 187 par 3 lidhur me par.1 e lidhur me neni 31 të KP-së, ku për këtë gjykata të akuzuarit i shpalli fajtor dhe ua shqiptoi dënimin me burgim me kusht në kohëzgjatje me nga 4 (katër) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin kohor prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse të akuzuarit nuk kryejnë vepër të re penale.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Gjatë vendosjes mbi dënimin, gjykata nuk ka gjetur ndonjë rrethanë të veçantë rënduese e cila do të ndikonte në llojin dhe lartësinë e dënimit, ndërsa si rrethana tejet lehtësuese ka konsideruar: pranimin e fajësisë nga të akuzuarit, të cilët në shqyrtim fillestar kanë theksuar se është e vërtetë që ka ndodhur problemi në mes tyre, ata janë familjarë, baba dhe tre fëmijë, janë acaruar dhe për një moment kanë sulmuar njëri-tjetrin, por tani i kanë rregulluar marrëdhëniet e tyre dhe janë penduar për veprimet e tyre. Po ashtu, atyre u vjen keq për rastin e ndodhur dhe i kanë premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të ndodh diçka e ngjashme.

Andaj duke u bazuar në këto rrethana, gjykata të akuzuarve i shqiptoi sanksionin penal sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke konsideruar se sanksioni shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë penale juridike të tij dhe se me këtë sanksion do të arrihet qëllimi preventiv i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale, gjykata e mori në kuptim të nenit 450, 451 dhe 453 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet në emër të kompensimit të viktimave është bazuar në nenin 39 par.3-1 të Ligjit për Kompensim të Viktimave të Krimit Nr.05/L-036.

Nga të cekurat më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.1803/18 të dt.15.05.2019

Sekretare Juridike
Birsen Shoshani

Gjyqtarja
Shpresa Emra

UDHËZIM JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.